



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT  
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 269 prot.

Tiranë më 5.2.2018

VENDIM

Nr. 04, datë 5 / 2 /2018

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur “Komisioneri”) ankimin nr. 1502 Prot., datë 16.11.2017, kundër Autoritetit Publik “Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar” (në vijim quajtur “Autoriteti Publik”), me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.

Ankuesi ka depozituar pranë Autoritetit Publik kërkesën për informacion si më poshtë:  
*Nga totali i kontrolleve të përfunduara nga ana e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar cili është numri i subjekteve të rivlerësimit që sipas vlerësimit të institucionit, rezultojnë se:*

- Kanë plotësuar formularin për kontrollin e figurës saktë dhe me vërtetësi. Sa e kanë plotësuar në mënyrë jo të saktë dhe si është vepruar me këto subjekte?*
- Për sa subjekte është konstatuar se kanë kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar? Të ç' natyre kanë rezultuar këto kontakte të papërshtatshme?*
- A janë konstatuar rrethana lehtësuese që janë marrë parasysh nga DSIK-ja për kontaktet e papërshtatshme? Të ç' natyre kanë qënë ato?*
- Për sa subjekte për të cilat janë konstatuar kontakte të papërshtatshme, është vlerësuar nga ana e DSIK-së se janë të përshtatshme për të vazhduar detyrën, dhe për sa është vlerësuar se nuk janë të përshtatshëm për të vazhduar ushtrimin e detyrës?*

Autoriteti Publik, me shkresën nr. 2540 Prot., datë 26.10.2017 ka kthyer përgjigje duke i vënë në dispozicion një pjesë të informacionit, si dhe duke argumentuar refuzimin e dhënies së informacionit për pjesën tjetër të tij.

Me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ankuesi ka paraqitur ankim pranë Zyrës së Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, Komisioneri, me Urdhrin nr. 304 datë 04.12.2017, vendosi fillimin e hetimit administrativ pranë Autoritetit Publik me qëllim verifikimin e fakteve dhe rrethanave që janë bërë pengesë për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar.

Lidhur me sa kërkohet në kërkesën për informim, përfaqësuesit e Autoritetit Publik argumentuan si më poshtë:

Në përgjigje të kërkesës për informim nr. 419 Prot., datë 9.8.2017, Autoriteti Publik ka kthyer përgjigje të detajuar për të gjitha kërkesat e parashtruara me anë të shkresës nr. 1971 prot., datë 29.08.2017.

Kërkesa për informacion është përsëritur me shkresën nr. 740 Prot., datë 3.10.2017, dhe Autoriteti Publik i ka kthyer sërish përgjigje me shkresën nr. 2540 Prot., datë 26.10.2017. Konkretisht, për pikën a) të kërkesës, është përmbushur detyrimi për dhënie informacioni. Përsa i përket pikave b), dhe d), Autoriteti Publik argumenton se informacioni përmban të dhëna sensitive, ekspozimi i të cilave mund të cenojë mbarëvajtjen e procesit si dhe të paragjykojë përfundimin e tij. Gjithashtu sqarohet se, informacioni i kërkuar lidhet me procesin që po kryen Grupi i Punës “Për Kontrollin e Figurës” i cili është informacion i klasifikuar.

Referuar pikës c) të kërkesës, Autoriteti Publik sqaron se rrethanat lehtësuese të cilat janë marrë parasysh janë ato të parashikuara në nenin 38 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Në mbështetje të argumenteve të tyre, përfaqësuesit e Autoritetit Publik, vendosën në dispozicion të grupit të inspektimit, në cilësinë e provës materiale, Urdhrin nr. 2125/1, datë 03.08.2017 “Për listën e dokumenteve të klasifikuara “sekret shtetëror” në Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar”, në pikën 21, 22, 23 dhe 24 të të cilit, është e përcaktuar në mënyrë të shprehur se dokumentet e prodhuara nga Grupi i Punës “Për Kontrollin e Figurës” i ngritur pranë DSIK-së, janë të klasifikuara. Krahas listës së dokumenteve të klasifikuara përcaktohet edhe niveli dhe afati i ruajtjes së klasifikimit.

Nga ana e tij, ankuesi pretendon se informacioni i kërkuar është kryesisht statistikor dhe i referohet asaj çka është konkluduar deri në momentin kur është bërë kërkesa për informim.

Në vijim të inspektimit pranë Autoritetit Publik, me qëllim marrjen e një vendimi sa më objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” në të cilin citohet se “Me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ..kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve”, me shkresën nr. 1502/3 Prot., datë 12.12.2017, Komisioneri ftoi palët në një seancë dëgjimore e cila u zhvillua me datë

27.12.2017. Gjatë seancës ankuesi dhe përfaqësuesi i Autoritetit Publik rikonfirmuan qëndrimet e tyre të reflektuara në aktet shkresore të trajtuara më sipër.

Zyra e Komisionerit vlerëson se në shqyrtimin e çështjes, gjejnë zbatim dispozitat e Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë mbi rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe të Ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

Neni A i Aneksit të Kushtetutës përcakton shprehimisht se me qëllim kryerjen e procesit të rivlerësimit, zbatimimi i disa neneve të Kushtetutës, veçanërisht atyre që lidhen ndër të tjera me të drejtën për respektimin e jetës private, kufizohen sipas nenit 17 të Kushtetutës. Neni 17 i Kushtetutës parashikon mundësinë e kufizimit të të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në Kushtetutë me ligj për një interes publik ose mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Nisur nga sa më sipër del qartë interesi publik që karakterizon procesin e rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Ky qëndrim mbështetet edhe nga Gjykata Kushtetuese në paragrafin 42 të Vendimit nr. 78 datë 12.12.2017 të saj ku thuhet shprehimisht se: *"...ndërrhyrja (duke iu referuar kufizimit të jetës private dhe familjare) në këtë rast justifikohet me interesin publik, që është ulja e nivelit të korrupsionit dhe rikthimi i besimit të publikut në sistemin e drejtësisë, pra lidhet me interesa të sigurisë kombëtare, sigurisë publike dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të të tjerëve. Për rrjedhojë, në rastin konkret ndërrhyrja është bërë për një qëllim të ligjshëm, në këndvështrim të paragrafit të dytë të nenit 8 të KEDNJ-së, si dhe në respektim të nenit A të Aneksit të Kushtetutës që kufizon këtë të drejtë".*

Pika 7 e nenit 6 të Ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", parashikon se e drejta e informimit, mund të kufizohet duke respektuar parimin e proporcionalitetit nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë për administrimin e procesit të rivlerësimit.

Vlen për tu theksuar se ky kufizim nuk gjen zbatim në rastin konkret pasi informacioni i kërkuar është informacion i një natyre statistikore dhe për rrjedhojë publikimi i tij nuk çënon procesin e rivlerësimit.

Lidhur me argumentin e parashtruar nga Autoriteti Publik se informacioni i kërkuar është i klasifikuar, duhet theksuar se ky argument bie ndesh me frymën e nenit 39 të Ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", ku përcaktohet procedura për kontrollin e figurës së gjyqtarit ose prokurorit.

Bazuar në këtë nen grupi i punës i ngritur për këtë qëllim, në përfundim të procesit të kontrollit, harton një raport/dokument i cili përmban informacion mbi kontaktet dhe kushtet e parashikuara në nenin 38 të ligjit të sipërpërmendur (çka përbën dhe objektin e kërkesës për informim të ankuesit) të cilin ia paraqet Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Nga fjalia e fundit e paragrafit 2 të nenit 39 të Ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" ku parashikohet se: *"...informacioni nuk bëhet publik nëse ai rrezikon sigurinë e burimit, ose për shkak të një kushti të përcaktuar nga qeveria e një shteti tjetër"*, rezulton se parimisht informacioni është publik dhe publikimi mund të kufizohet vetë nëse plotësohen kushtet e parashikuara më sipër.

Edhe nëse do të ishim përpara një rasti të tillë, në bazë të nenit 17, pika 6 e Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ku përcaktohet se: *“Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit”*, Autoriteti Publik është i detyruar që ta vërë informacionin në dispozicion të kërkuarit duke treguar qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe pikën e këtij neni sipas së cilës është bërë ky refuzim.

Sa i përket kufizimeve të së drejtës për informim të parashikuara në nenin 17 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, theksojmë se në rastin specifik nuk zbatohen kufizimet e parashikuara në të për shkak të interesit publik që i është atribuuar këtij procesi nga Kushtetuta, kushi i parashikuar dhe nga vetë ky nen si shkak për mozbatimin e kufizimeve të së drejtës për informim.

Sa i përket Urdhrit nr. 2125/1, datë 03.08.2017 *“Për listën e dokumenteve të klasifikuara “sekret shtetëror””* në Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar”, Zyra e Komisionerit vlerëson se përmbajtja e tij nuk mund të vijë në kundërshtim me dispozitat e Kushtetutës dhe ligjeve materiale të Republikës së Shqipërisë të përmendur më sipër, të cilat në hierarkinë e akteve ligjore kanë përparësi mbi të.

Gjithashtu, nga thëniet e përfaqësuesit të Autoritetit Publik gjatë seancës dëgjimore, si dhe nga informacioni i pasqyruar në përgjigjet që Autoriteti Publik i ka kthyer ankuesit (shkresat nr. 1971 Prot. Datë 29.08.2017 dhe nr. 2540 Prot. Datë 26.10.2017), Komisioneri ka konstatuar se Autoriteti Publik e zotëron informacionin e kërkuar nga ankuesi dhe nuk jemi përpara një informacioni që Autoriteti Publik duhet ta prodhojë rishtazi.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se Autoriteti Publik ka përmbushur detyrimin në lidhje me pikën a), por nuk ka përmbushur detyrimin për dhënie informacioni sipas kërkesës për informim për pikat e tjera, megjithëse disponon informacionin e kërkuar dhe ky i fundit përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i cili përcakton se: *“Informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik”*.

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të ligjit sipërcituar, *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”*.

Në përmbushje të detyrimeve që burojnë nga legjislacioni i shqyrtuar dhe përmendur më sipër, Zyra e Komisionerit vlerëson se Autoriteti Publik duhet të ketë gjithashtu në vëmendje nenet 5, 6 dhe 7 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar në raport me personat e tjerë, jo subjekt i procesit të rivlerësimit.

Theksojmë, se e drejta për t’u informuar është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën e Komitetit Shqiptar të Helsinkit ndaj Autoritetit Publik, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, Komisioneri vlerëson se ankesa është e bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

### PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5, të nenit 24, nenit 25, të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18, të ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative”, dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative’.

### V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës së Komitetit Shqiptar të Helsinkit me Nr. 1502 Prot., datë 16.11.2017, ndaj Autoritetit Publik, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, për vënien në dispozicion të informacionit:
  - Për sa subjekte është konstatuar se kanë kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar? Të ç’natyre kanë rezultuar këto kontakte të papërshtatshme?
  - A janë konstatuar rrethana lehtësuese që janë marrë parasysh nga DSIK-ja për kontaktet e papërshtatshme? Të ç’natyre kanë qenë ato?
  - Për sa subjekte për të cilat janë konstatuar kontakte të papërshtatshme, është vlerësuar nga ana e DSIK-së se janë të përshtatshme për të vazhduar detyrën, dhe për sa është vlerësuar se nuk janë të përshtatshëm për të vazhduar ushtrimin e detyrës, brenda datës 15. 2 .2018.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”
4. Ky vendim u shpall sot me datë 05. 2 .2018.

